



REPUBLIKA E KOSOVËS
ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM

Nr. i dokumentit: 22.21.1-2011-08

RAPORTI I AUDITIMIT
PËR PASQYRAT VJETORE FINANCIARE TË KOMUNËS SË
SHTËRPCËS PËR VITIN E PËRFUNDUAR ME 31 DHJETOR 2011

Prishtinë, Qershor 2012

TABELA E PËRMBAJTJES

Lista e shkurtesave	4
Përmbledhje e përgjithshme	5
1 Hyrje.....	7
2 Opinioni i auditimit	9
3 Gjendja e rekomandimeve të vitit të kaluar	10
4 Rezultati financiar në krahasim me Buxhetin e Aprovuar	11
5 Pasqyrat financiare - Pajtueshmëri me kornizën raportuese dhe cilësinë e informacionit.....	12
6 Menaxhimi Financiar	13
6.1 Të hyrat vetjake.....	13
6.2 Shpenzimet	13
6.3 Pasuritë	15
6.4 Raportimi aktual dhe afatet kohore për procesin e përgjithshëm buxhetor	15
7 Kontrolli mbi menaxhimin	16
7.1 Sistemet e Kontrollit të Brendshëm.....	16
7.2 Auditimi i Brendshëm	17
8 Një konkluzion i Përgjithshëm mbi Menaxhmentin e Shtërpcës	18
Shtojca I. Llojet e ndryshme të Opinioneve të Auditimit.....	19
Shtojca II. Rekomandimet e vitit të kaluar	21

Lista e shkurtesave

AB	Auditimi i Brendshëm
FNK	Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve
ISA	Institucioni Suprem i Auditimit
KA	Komiteti i Auditimit
KBFP	Kontrolli i Brendshëm i Financave Publike
LAB	Ligji për Auditimin e Brendshëm
LMFPP	Ligji 03/L-48 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë
LPP	Ligji për Prokurimin Publik nr.03/L-241 i ndryshuar me Ligjin nr. 04/L-042 në fuqi prej 05.10.2011
MF	Ministria e Financave
MF/K	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli
NJAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm
NJQH/AB	Njësia Qendrore Harmonizuese e Auditimit të Brendshëm
ONISA	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI)
OSHP	Organi Shqyrtues i Prokurimit
PVF	Pasqyrat Vjetore Financiare
RVP	Raporti Vjetor i Performancës
Rr F	Rregullat financiare të nxjerra nga Ministria e Financave
SIMFK	Sistemi Informativ për Menaxhimin e Financave të Kosovës
SNISA	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (ISSAI)
SNKSP	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik (IPSAS)
ZAP	Zyra e Auditorit të Përgjithshëm

Përmbledhje e përgjithshme

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) ka kryer auditimin e Pasqyrave Vjetore Financiare (PVF) të Komunës së Shtërpçës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2011.

Auditimi ynë është kryer në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, të hartuara nga INTOSAI (ONISA) dhe ka përfshirë testimet dhe procedurat që ne menduam se ishin të nevojshme për të dhënë një opinion lidhur me PVF.

Sipas opinionit tonë Pasqyrat Vjetore Financiare prezantojnë *pamje të drejtë dhe të vërtetë* në të gjitha aspektet materiale.

Ne dëshirojmë të tërheqim vëmendjen tuaj në faktin se Komuna e Shtërpçës nuk i ka shpalosur në mënyrë të plotë dhe të saktë informacionet për pasuritë. Kjo nuk ka ndikim në opinionin mbi PVF të hartuara në pajtim me SNKSP sipas kontabilitetit të parasë së gatshme (SNISA 400: *Opinion i Pakualifikuar me Theksim të Çështjes*).

Gjatë vitit 2011, Komuna nuk kishte trajtuar në mënyrën e duhur rekomandimet e dhëna në raportin tonë të auditimit për vitin 2010. Ajo nuk kishte përgatitur planin e adresimit të rekomandimeve si dhe asnjë rekomandim nuk ishte adresuar.

Auditimi ynë ka identifikuar dobësi në disa fusha të menaxhimit financiar. Këto dobësi janë përshkruar më gjerësisht në brendi të këtij raporti.

Konkluzioni ynë i përgjithshëm është se Menaxhmenti i Komunës ka nevojë të ndërmerr veprime përmirësuese të mëtutjeshme dhe të inkurajoj vendosjen e kontrolleve të brendshme në të gjitha fushat.

Me qëllim që të përmirësohet funksionimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontrolleve të brendshme në afat të shkurtër, ne rekomandojmë Kryetarin që të siguroi:

- Se janë nxjerrë politika, procedura dhe udhëzime të qarta për të gjitha proceset/aktivitetet e rëndësishme, si: planifikimi i buxhetit, prokurimi, menaxhimi i shpenzimeve dhe investimeve kapitale, si dhe raportimin.
- Se buxheti përgatitet bazuar në objektivat vjetore, duke u përshtatur me nevojat objektivist të realizueshme dhe duke u pasuar me një plan të qartë kohor të rrjedhës së parasë;
- Se Plani i prokurimit përgatitet me kohë dhe duhet të shërbej si bazë për përcaktimin e buxhetit. Gjithashtu, monitorimi i kontratave do të përmirësohet;
- Një Rregullore mbi ndarjen e subvencioneve do të miratohet;
- Se do të bëhet regjistrimi i plotë i pasurisë dhe mbajtja e evidencave sipas UA 21/2009;

- Përmirësimi i funksionimit të kontrollit të brendshëm; dhe
- Roli i auditimit të brendshëm do të fuqizohet dhe do të themelohet Komiteti i Auditimit.

Menaxhmenti i Komunës është pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet tona të paraqitura në raportin e auditimit mbi PVF për vitin 2011 dhe është zotuar se do t'i bëjë të gjitha përpjekjet për t'i adresuar të gjitha rekomandimet e dhëna.

1 Hyrje

Ky auditim ka të bëjë me PVF të Komunës së Shtërpcës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2011.

Është përgjegjësi e Komunës së Shtërpcës të përgatisë PVF sipas kërkesave të Rregullës Financiare Nr. 07/2011 dhe në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (SNSKP) për "Raportimin financiar në bazë të kontabilitetit të parasë së gatshme".

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) është përgjegjëse për kryerjen e auditimeve vjetore të rregullsisë për Komunën e Shtërpcës.

Auditimi i rregullsisë përkufizohet si një verifikim i kontabilitetit financiar, duke përfshirë ekzaminimin dhe vlerësimin e PVF dhe të dhënave tjera financiare si dhe dhënien e mendimeve:

- Nëse PVF japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Ne kemi kryer auditimin e ndërmjetëm të Komunës së Shtërpcës. Gjatë asaj faze të auditimit, kemi adresuar faktin se si janë trajtuar rekomandimet e mëparshme, Pasqyrat Financiare nëntë mujore si dhe cilësinë e menaxhimit financiar. Po ashtu, kemi këshilluar menaxhmentin për adresimin e çështjeve në pasqyra financiare, përmes memorandumit të auditimit të dorëzuar në dhjetor 2011.

Me qëllim të përmbushjes së përgjegjësiave tona për auditimin e komunës, ne kemi ndërmarrë aktivitetet si në vijim:

- Kemi rishikuar PVF të komunës në raport me buxhetin e miratuar për vitin 2011;
- Kemi kryer teste substanciale gjithëpërfshirëse mbi transaksionet financiare;
- Kemi përcaktuar nivelet e materialitetit të të hyrave dhe shpenzimeve, si prag për lehtësimin e përcaktimit të llojit të opinionit që duhet dhënë mbi pasqyrat financiare;
- Jemi mbështetur në një lloj kombinimi të intervistave, rishikimeve analitike, rishikimin e dokumenteve dhe verifikimin fizik për të vlerësuar vlefshmërinë dhe rregullsinë e transaksioneve financiare;
- Kemi përcaktuar nëse PVF të Komunës së Shtërpcës, janë përgatitur në pajtim me SNKSP "Raportimi Financiar në bazë të Kontabilitetit të Parasë së Gatshme"; dhe

- Kemi vlerësuar se a është Njësia e Auditimit të Brendshëm funksionale.

Në këtë raport ne përmbledhim auditimin e këtij viti dhe japim një opinion formal mbi PVF 2011.

Lidhur me opinionin tonë të auditimit për PVF të Komunës së Shtërpcës, SNISA përcaktojnë kriteret specifike të cilat rregullojnë llojin e opinionit që mund të jepet.

Këto janë të përcaktuara më gjerësisht në Shtojcën I.

2 Opinioni i auditimit

Sipas opinionit tonë Pasqyrat Vjetore Financiare prezantojnë *pamje të drejtë dhe të vërtetë* në të gjitha aspektet materiale.

Ne dëshirojmë të tërheqim vëmendjen tuaj në faktin se Komuna e Shtërpçës nuk i ka shpalosur në mënyrë të plotë dhe të saktë informacionet për pasuritë. Kjo nuk ka ndikim në opinionin mbi PVF të hartuara në pajtim me SNKSP sipas kontabilitetit të parasë së gatshme (SNISA 400: *Opinion i Pakualifikuar me Theksim të Çështjes*).

3 Gjendja e rekomandimeve të vitit të kaluar

Opinionimi për PVF për vitin 2010 ishte *opinion i kualifikuar*. Bazë për kualifikim ishte se:

- Komuna nuk ka shpalosur tek notat e PVF, grantet qeveritare të pranuar nga Buxheti i konsoliduar i Kosovës siç kërkohet në nenin 10 të paragrafit 4 të rregullores administrative 16/2010; dhe
- Komuna nuk ka shpalosur tek notat e PVF, informatat në lidhje me asetet fikse siç kërkohet në nenin 15, paragrafi 1 dhe 2 i rregullores administrative 16/2010 (2009: 20/2009).

Në raportin e auditimit të PVF për vitin 2010 ishin dhënë 4 rekomandime. Nga to asnjë rekomandim nuk ishte adresuar. Rekomandimet e vitit të mëhershëm janë paraqitur në shtojcën II të këtij raporti.

Mos adresimi i plotë i rekomandimeve tona, ka shkaktuar të njëjtat probleme si në vitet e kaluara. Fakti se asnjë nga rekomandimet e dhëna nuk është adresuar, shpreh mungesën gatishmërisë së menaxhmentit për të ndërmarrë veprime përmirësuese. Dhe, derisa veprimet e duhura nuk ndërmerren, mangësitë e theksuara më lartë do të vazhdojnë të ekzistojnë.

Kryetari i komunës dhe menaxherët përgjegjës të fushave ku janë identifikuar dobësitë dhe mangësitë menaxheriale, duhet të diskutojnë një Plan masash të veprimit për të adresuar çështjet e ngritura nga auditimi.

4 Rezultati financiar në krahasim me Buxhetin e Aprovuar

Analiza e Rezultatit në Pasqyrat Financiare kundrejt Buxhetit të Aprovuar tregon:

Tabela 1: Pasqyra e buxhetit dhe shpenzimeve Në euro (€)

Përshkrimi	Buxheti Fillestar	Buxheti Final	Pranimet/ Shpenzimet 2011	Pranimet/ Shpenzimet 2010
Grandi i Qeverisë – Buxheti	2,839,062	4,165,017	3,625,023	3,645,911
Të hyrat vetjake të vitit 2011	69,035	189,806	237,000 ¹	114,263
Të hyrat e bartura nga 2010	0	50,724	50,724	34,119
Donacionet e vendit	0	0	0	0
Donacionet e jashtme	0	31,307	28,904	12,130
I. Gjithsej pranimet dhe transferi i donacioneve	2,908,097	4,436,854	3,941,651	3,806,423
Pagat dhe mëditjet	1,871,386	1,750,987	1,338,840	1,001,991
Mallra dhe shërbime	327,257	469,612	340,372	177,908
Shpenzimet Komunale	51,442	55,942	55,941	33,154
Subvencionet dhe transferet	10,314	10,314	10,314	5,600
Investimet Kapitale	647,698	2,149,999	2,144,908	2,537,046
Rezervat	0	0	0	
II. Gjithsej shpenzimet	2,908,097	4,436,854	3,890,375	3,755,699
Diferenca I-II	0	0	51,276	50,724 ²

Nga tabela mund të shohim se buxheti final është më i madh nga buxheti fillestar për shumën prej 1,528,757€. Kjo rritje e buxhetit është shkaktuar në bazë të vendimit të Kryeministrit Nr. 01/142 me datën 26.08.2010 në shumë prej 1,323,000€ për investimet kapitale, shtim i mjeteve në kategorinë e pagave dhe mëditjeve për 2,955€, të hyrave vetjake 171,495€ dhe donacioneve në vlerë 31,307€.

Diferenca 51,276€ është e hyrë vetjake e pa shpenzuar, e bartur në vitin 2012.

¹ Të hyrat e mbledhura në 2011

² Të hyrat vetjake të pa shpenzuara në fund të vitit 2010, të bartura në vitin 2011.

Shpenzimet totale ishin për 546,479€ më pak në krahasim me buxhetin final, përkatësisht buxheti final ishte shpenzuar rreth 88%. Tepricë më e theksuar e buxhetit të pa shpenzuar prej 412,147€ është shënuar te pagat dhe mëditjet, ngase komuna nuk kishte arritur t'i punësoj 119 punëtorë të shëndetësisë sekondare, siç ishte planifikuar më herët.

Konkluzion

Komuna e Shtërpçës vetëm në tremujorin e fundit ka shpenzuar 52% të buxhetit total, çka është një tregues se hartimi i buxheteve dhe politikat e ekzekutimit kërkojnë përmirësime substanciale. Buxheti i pa shpenzuar prej 12% më pak në krahasim me buxhetin final, gjithashtu flet për nevojën e forcimit të kontroleve buxhetore.

Rekomandimi 1

Rekomandojmë Kryetarin e Komunës që të siguroj:

- Përgatitjen e buxhetit vetëm pas një analize gjithëpërfshirëse të nevojave reale. Gjithashtu, plani real i rrjedhës së parasë të harmonizohet me aktivitetet vjetore të prokurimit (dinamikën e realizimit të projekteve kapitale dhe furnizimet me mallra dhe shërbime).

5 Pasqyrat financiare – Pajtueshmëri me kornizën raportuese dhe cilësinë e informacionit

Komuna ka arritur të përgatisë PVF sipas Rregullës Financiare nr. 07/2011 mbi raportimin vjetor të organizatave buxhetore me përjashtim të shpalosjeve të pasurisë fikse;

Kërkesat e LMFPP nr. 03/L-048 dhe Rregullës Financiare nr.07/2011.

- PVF janë nënshkruar nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar;
- PVF janë nënshkruar brenda kornizës kohore me datën 31/01/2012 dhe janë dërguar në MF;
- PVF janë përgatit vetëm në gjuhën shqipe dhe serbe; dhe
- Nuk është paraqitur në PVF shuma e pasurisë fikse e komunës me të cilën disponon.

Konkluzion

Me përjashtim të mangësisë së shpalosjeve të pasurisë, PVF të komunës në përgjithësi ofrojnë informata në pajtim me rregullat e raportimit financiar në bazë të kontabilitetit sipas parasë së gatshme. Përkundër rekomandimit të dhënë vitit të kaluar, komuna nuk ka ndërmarrë veprimet e duhura për raportimin e pasurive.

Rekomandimi 2

Rekomandojmë Kryetarin e Komunës që:

- Në PVF të paraqes gjithë pasurinë e saj, si një kërkesë ligjore, dhe me këtë të kompletoj informatat e duhura.

6 Menaxhimi Financiar

6.1 Të hyrat vetjake

Të hyrat vetjake të mbledhura nga komuna për vitin 2011 ishin 237,000 €.

Në fazën e parë të auditimit tonë, te të hyrat vetanake, ne kemi vërejtur dy parregullsi, dhe atë:

- Nuk janë barazuar të hyrat vetanake ndërmjet departamenteve dhe zyrtarit për të hyra dhe
- Nuk ishin kryer depozitimet e përditshme të të hyrave të inkasuara në bankë.

Ne kemi këshilluar menaxhmentin e Komunës t'i eliminoj këto parregullsi gjatë fazës të ndërmjetëm të auditimit dhe kemi vërejtur se këshilla jonë është pranuar dhe implementuar dhe këto dobësi janë eliminuar.

Pas kontrollimit të dokumentacionit në dispozicion, ne nuk kemi identifikuar ndonjë parregullsi të rëndësishme në lidhje me llogaritjet dhe inkasimin e të hyrave vetjake. Zyrtari për të hyra tani rregullisht kryen harmonizimin si me departamentet ashtu edhe me Bankën Qendrore.

6.2 Shpenzimet

6.2.1 Prokurimi

Ne kemi vërejtur se komuna nuk kishte Plan përfundimtar të prokurimit për vitin 2011.

Vlera e kontratave të nënshkruara ishte 2,374,028€, ne kemi testuar 34 mostra që mbulojnë 1,518,412€ të pagesave të shpenzimeve të udhëhequra përmes procedurave të prokurimit. Ne kemi vërejtur se në 16 raste ka pasur vonesa në përfundimin e punimeve. Vetëm në një rast ishin zbatuar penalet në pajtim me kontratën.

Konkluzion

Fakti se komuna nuk kishte Plan përfundimtar të prokurimit, ndikon drejtpërdrejt në parashikimet buxhetore dhe në ekzekutimin e tij. Politikat e planifikimit duhet dukshëm të përmirësohen. Po ashtu, vonesat e shumta në realizimin e projekteve janë një tregues se monitorimi i kontratave është i dobët.

Rekomandimi 3

Rekomandojmë Kryetarin e Komunës që të siguroj:

- Përgatitjen e planit vjetor të prokurimit, duke i specifikuar qartë të gjitha projektet dhe nevojat për furnizime; dhe
- Të forcoj kontrollat e monitorimit të kontratave, në mënyrë që punimet apo furnizimet të kryhen brenda afateve kontraktuese.

6.2.2 Kompensimet (pagat dhe mëditjet,)

Buxheti i miratuar për paga dhe mëditje për Komunën e Shtërpçës ka qenë 1,750,987€, derisa shpenzimet reale kanë qenë 1,338,840€, ose 76,5% të shfrytëzimit të buxhetit për këtë kategori. Arsyja për këtë mos shfrytëzim të mjeteve për këtë kategori qëndron në atë se nuk ishin punësuar 119 punëtor në shëndetësinë sekondare pasi që spitali nuk ishte ndërtuar ende.

Me testimin e 29 mostrave ne nuk kemi vërejtur ndonjë parregullsi, të rëndësishme për t'u raportuar.

6.2.3 Subvencionet dhe transferet

Shpenzimet e tërësishme për subvencione kanë qenë 10,3140€. Ne kemi ekzaminuar 6 njësi mostre në vlerë prej 2,496€ apo 24% të tërësisë. Me këtë rast, nuk kemi vërejtur ndonjë parregullsi, përveç se komuna nuk ka Rregullore mbi subvencionet. Subvencionet janë ndarë nga kryetari i komunës, në bazë të kërkesave të parashtruesve.

Konkluzion

Mungesa e Rregullores për ndarjen e subvencioneve mund të ndikoj në shfrytëzimin joracional të buxhetit për këtë kategori dhe favorizimin eventual të kandidatëve gjatë ndarjes së tyre.

Rekomandimi 4

Rekomandojmë Kryetarin e Komunës të siguroj:

- Përgatitjen e Rregullores së brendshme, duke specifikuar qartë kriteret dhe procedurat për ndarjen e subvencioneve, për të parandaluar çfarëdo parregullsish.

6.3 Pasuritë

6.3.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Komuna e Shtërpcës ka zyrtar për pasuri, mirëpo nuk ka arritur ta kryej regjistrimin, vlerësimin dhe inventarizimin e pasurisë për vitin 2011, për të përcaktuar ekzistencën fizike dhe vlerën e gjithë pasurisë, si dhe mënyrën se si menaxhohet ajo. Është formuar komisioni për regjistrim dhe vlerësim të pasurisë, mirëpo ende nuk ka përfunduar punën e vet dhe ne nuk na është prezantuar ndonjë raport mbi punën e tyre. Gjatë bisedave me menaxhmentin, ky i fundit është zotuar se do ta kompletojnë regjistrin qendror të pasurisë dhe do ta implementojnë UA 21/2009 në tërësi, jo më larg se në fund të vitit 2012.

Konkluzion

Gjetjet aktuale të auditimit lidhur me pasuritë po përsëriten që nga viti 2007, pavarësisht kësaj nuk janë vërejtur ndryshime pozitive deri më tani.

Rekomandimi 5

Rekomandojmë Kryetarin e Komunës të siguroj:

- Kompletimin e regjistrit të pasurive në pajtim me Udhëzimin Administrativ Nr. 21/2009 mbi regjistrimin dhe menaxhimin e pasurive.

6.4 Raportimi aktual dhe afatet kohore për procesin e përgjithshëm buxhetor

Komuna kishte përgatitur:

- Raportet tremujore, duke përfshirë edhe pasqyrat financiare nëntë mujore me kohë.
- Raportet mbi borxhet e dorëzuar në MF;

Komuna nuk kishte përgatitur planin e adresimit të rekomandimeve për vitin 2010.

7 Kontrolli mbi menaxhimin

7.1 Sistemet e Kontrollit të Brendshëm

Komuna e Shtërpcës nuk ka arritur të ndërtoj një sistem funksional të kontrollit të brendshëm. Për më tepër, menaxhmenti nuk inkurajon në masë të mjaftueshme zhvillimin e kontrolleve të brendshme. Dështimi në adresimin e rekomandimeve të auditimit për vite me radhë, është një tregues se gatishmëria për t'u marr me veprime përmirësuese dhe vendosjen e kontrolleve të duhura mungon.

Dobësitë dhe çasja jo e duhur vërehet edhe tek planifikimi i buxhetit. Buxheti nuk bazohet në analizat e duhura paraprake dhe nuk harmonizohet me aktivitetet operative të komunës. Mungesa e hartimit me kohë e planeve të prokurimit ndikon në pasaktësitë e planifikimit dhe shkallën e ekzekutimit total të buxhetit. Për pasojë shfaqen teprica buxhetore, ndërsa shumë kërkesa reale ka gjasa të mbesin të pa plotësuara. Gjithashtu, nuk ka kontrolle mbi alokimin e shpenzimeve nëpër periudha dhe kjo ka rezultuar me shpenzimin e gjysmës së buxhetit në tre muajt e fundit.

Të hyrat vetjake në krahasim me planin janë realizuar më shumë për 25%. Kjo shkallë realizimi nuk nënkupton ndonjë planifikim të mirë, por më shumë flet për një planifikim ad hoc, sepse në strukturën e financimit të hyrat vetjake marrin pjesë me vetëm 6%. Kjo flet për nevojën dhe analizën më gjithëpërfshirëse të ngarkesave me taksa dhe tatime të personave juridik dhe atyre fizik.

Monitorimi i kontratave është i dobët. Vonesat në realizimin e projekteve shfaqen në shumë raste dhe menaxhmenti nuk ndëshkon operatorët.

Fusha gjithsesi më problematike paraqitet menaxhimi i pasurive. Komuna edhe pas kaq vitesh nuk ka zyrtar të pasurive dhe as regjistër definitiv të pasurive. Një nga objektivat kryesore të KBFP është ruajtja dhe mirë menaxhimi i pasurive. Në kushtet kur mungojnë regjistrat kontabël dhe nuk bëhet numërimi fizik i pasurive, një menaxhim i mirë bëhet i pamundur.

Konkluzion

Sistemi i kontrollit të brendshëm kërkon vendosje të udhëzimeve dhe procedurave të qarta të kontrolleve. Në formën aktuale, kontrollet e brendshme nuk ofrojnë sigurinë e duhur se objektivat e përcaktuara komunës po arrihen.

Rekomandimi 6

Rekomandojmë Kryetarin e Komunës që:

- Të bëj rishikimin funksional të kontrollit të brendshëm, në mënyrë normative ka definuar procedurat e kontrollit dhe identifikimin e rrezikut si dhe ka krijuar një rrjedhë efikase të informimit dhe komunikimit brenda organizatës.

7.2 Auditimi i Brendshëm

Komuna ka themeluar NJAB, i përbërë nga vetëm një anëtarë i cili është njëkohësisht drejtor i saj. NJAB nuk ka kryer asnjë raport të auditimit për vitin 2011. Plani strategjik dhe vjetor është përgatitur. Gjatë auditimit ne nuk kemi pasur në dispozicion asnjë raport nga NJAB për vitin 2011. Të gjitha raportet të cilat i ka përgatitur NJAB i referoheshin vitit 2010.

Komuna ende nuk ka themeluar Komitetin e Auditimit.

Konkluzion

NJAB, sipas mendimit tonë, do të duhej të merrej me problematikën aktuale gjatë vitit. T'i identifikoj me kohë dobësitë dhe parregullsitë eventuale dhe me sugjerimet, propozimet dhe rekomandimet e veta për menaxhmentin, t'i kontribuoj adresimit dhe implementimit të tyre.

NJAB kishte dështuar në përmbushjen e planin vjetor të punës. Kjo nuk i ndihmon menaxhmentit të komunës që të ketë një pasqyrë të qartë mbi efektivitetin e kontroleve.

Mos themelimi i Komitetit të auditimit, që është obligim ligjor, rezulton në mungesën e kontrollit adekuat mbi punën e NJAB si dhe kontrollin mbi zbatimin e këshillave, sugjerimeve dhe rekomandimeve eventuale nga ana e NJAB.

Rekomandimi 7

Rekomandojmë Kryetarin e Komunës që të siguroj:

- NJAB kryesisht do të fokusohet në ndjekjen e aktiviteteve të vitit aktual dhe në fushat më problematike, si: prokurimi dhe pasuritë; dhe
- Të formoj Komitetin për auditim në afat sa më të shkurtër, me çka do të fuqizonte funksionin e auditimit të brendshëm.

8 Një konkluzion i Përgjithshëm mbi Menaxhmentin e Shtërpcës

Konkluzioni i përgjithshme

Konkluzioni ynë i përgjithshëm është se Menaxhmenti i Komunës ka nevojë të ndërmer veprime të mëtutjeshme dhe të inkurajoj vendosjen e kontroleve të brendshme në të gjitha fushat.

KBFP është dokumenti bazë me të cilin duhet të njihen si menaxherët ashtu edhe i tërë stafi i komunës. Nevoja për ngritjen e transparencës dhe llogaridhënies në të gjitha nivelet e organizatës është një nga kërkesat bazike për ndërtimin e një strukture të mirë të qeverisjes. Në kuadër të kornizës së KBFP, procedurat e menaxhimit financiar dhe kontrollit duhet të jenë të qarta për të gjithë, në mënyrë që më pastaj të zbatohen. Niveli i duhur i njohurive dhe aftësive të menaxhmentit duhet të vlerësohet, për të siguruar zbatimin e suksesshëm të kërkesave të kësaj kornize.

Menaxhmenti i komunës duhet që në mënyrë të përhershme të siguroj raportime të besueshme financiare dhe të vlerësoj rrezikun e shfaqjes së gabimeve materiale dhe parregullsive në pasqyrat vjetore financiare. Rreziku duhet vlerësuar edhe tek menaxhimi i pasurive nën kushtet kur mungojnë evidencat dhe regjistrat e plotë.

Rekomandimi i përgjithshëm

Rekomandojmë Kryetarin e Komunës që të siguroj:

- Nxjerrjen e politikave, procedurave dhe udhëzimeve të qarta për të gjitha proceset/aktivitetet e rëndësishme, si: planifikimi i buxhetit, prokurimi, menaxhimi i shpenzimeve dhe investimeve kapitale, si dhe raportimin.

Shtojca I. Llojet e ndryshme të Opinioneve të Auditimit

(e shkëputur nga ISSAI 400)

9. Një opinion i auditimit normalisht është një format standard, ndërlidhur me pasqyrat financiare si tërësi, duke shmangur nevojën për të caktuar gjatësinë e saj por duke bartur sipas natyrës së saj një kuptim të përgjithshëm tek lexuesit sipas kuptimit të saj. Natyra e këtyre fjalëve do të ndikohet nga korniza ligjore të auditimit, por përbërja e opinionit duhet të tregoj qartë a është i pakualifikuar apo i kualifikuar, apo nëse është i kualifikuar në disa çështje të caktuara apo është opinion i kundërt (paragrafi 14), apo është mohim i opinionit (paragrafi 15).

10. Një opinion i pakualifikuar jepet kur auditori është i kënaqur në të gjitha aspektet materiale që:

(a) pasqyrat financiare janë përgatitur duke shfrytëzuar baza dhe politika të pranuar të kontabilitetit të cilat janë zbatuar në mënyrë konsistente (të qëndrueshme);

(b) pasqyrat janë në pajtim me kërkesat statusore dhe rregulloret relevante;

(c) pamja e paraqitur në pasqyrat financiare janë në përputhje me njohuritë e auditorit në lidhje me entitetin e audituar;

(d) është një shpalesje adekuate e të gjitha çështjeve materiale relevante për pasqyrat financiare.

11. Theksi i çështjeve. Në disa rrethana auditori mundet të konsideroj se lexuesi nuk do të kuptoj në mënyrë të duhur pasqyrat financiare nëse vëmendja është përqendruar në çështje të pazakonshme apo të rëndësishme. Si një rregull e përgjithshme, auditori kur jep një opinion të pakualifikuar kjo nuk i referohet ndonjë aspekti specifik të pasqyrave financiare në opinionin e tij në rast se kjo mund të interpretohet gabimisht si opinion i kualifikuar. Me qëllim të shmangies së kësaj përshtypjeje, referencat që janë menduar si; nënvizim i çështjes; gjinden në paragrafët e ndara nga opinionin. Sidoqoftë, auditori nuk duhet të përdor nënvizimin e çështjes për të përmirësuar mungesën e shpalesjeve të duhura në pasqyrat financiare apo si alternativ, zëvendësim për kualifikim të opinionit.

12. Auditori mund të mos jetë në gjendje të shpreh një opinion jo të kualifikuar kur ekziston një nga ato rrethana dhe në gjykimin e auditorëve, afektin e tyre është ose mund të jetë materiale për pasqyrat financiare:

- (a) Ka pasur limitime në fushëveprimin e auditimit;
- (b) Auditori konsideron që pasqyrat janë jo komplete apo çorientues apo ekziston një ndarje e pajustificuar nga standardet e pranueshme të kontabilitetit; apo
- (c) Ekzistojnë paqartësi që ndikojnë në pasqyrat financiare.

13. Opinioni i Kualifikuar. Aty ku auditori nuk pajtohet apo nuk është i sigurt në lidhje me një ose me tepër artikuj të veçantë në pasqyrat financiare e që janë materiale por jo edhe fundamentale në kuptimin e pasqyrave, duhet të jepet një opinion i kualifikuar. Formulimi i opinionit normalisht tregon një rezultat të kënaqshëm ndaj subjektit të audituar, sa i përket një pasqyre të qartë dhe koncize, të çështjeve të mospajtimit apo edhe të paqartësive që ngrisin opinion e kualifikuar.

I ndihmon përdoruesit e pasqyrave nëse efekti financiar i paqartësisë apo edhe i mosmarrëveshjeve është përcaktuar nga ana e Auditorit edhe pse kjo nuk është gjithmonë praktike apo relevante.

14. Opinioni i Kundërt. Aty ku Auditori nuk ka mundësi të jap një opinion mbi pasqyrat financiare në tërësi, për shkak të mosmarrëveshjeve që është aq thelbësore ngase e minon pozitën e prezantuar në vazhdim që opinionin që kualifikohet në aspekte të caktuara nuk do të jetë adekuat, atëherë jepet opinion i Kundërt. Formulimi i një opinionin të tillë e bën të qartë se pasqyrat financiare nuk janë prezantuar në mënyrë të drejtë, duke specifikuar qartë dhe në mënyrë koncize të gjitha çështjet e mosmarrëveshjeve. Përsëri, është një ndihmesë që efekti financiar mbi pasqyrat financiare përcaktohet aty ku duhet dhe është praktik.

15. Mohimi i Opinioni. Aty ku Auditori nuk mund të jep opinion në lidhje me pasqyrat financiare, të marrë si tërësi për shkak të paqartësisë apo restriksionit të fushëveprimit që është thelbësor që një opinion që është i kualifikuar në aspekte të caktuara nuk do të jetë adekuat, jepet opinion i kundërt. Formulimi i një opinionin të tillë e bën të qartë që një opinion nuk mund të jepet, duke specifikuar në mënyrë të qartë dhe koncize të gjitha çështjet e paqarta.

16. Është bërë zakon që ISA të ofrojnë një raport të detajuar për të plotësuar opinion në rrethana në të cilat është e pamundur të jepet një opinion jo i kualifikuar.

Shtojca II. Rekomandimet e vitit të kaluar

Komponenta e auditimit	Rekomandimi i dhënë	Rekomandimi i adresuar plotësisht	Pjesërisht adresuar	I pa adresuar
1. Pasqyrat financiare	Përgatitjen e PVF në pajtim të plotë me Rregullën financiare Nr. 07/2011.			X
2.1 Personeli	Kompensimi për të gjithë stafin të jetë i bazuar në ligjet e aplikueshme dhe Udhëzimeve Administrative të cilat janë aktualisht në fuqi.			X
2.2 Prokurimi	Procedurat e prokurimit të jenë në pajtim me LPP;			X
1.1 Menaxhimi i pasurive	Regjistrimin e pasurisë në pajtim me UA nr.21/2009.			X
Totali	4	0	0	4